

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit I.I., nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson A. K., avokat nga ..., kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson R. K., nga Prishtina, punëtor i të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5579/2017 datë 28.2.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.6.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5579/2017 datë 28.2.2019.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5579/2017 datë 28.2.2019, është pranuar pjesërisht si e bazuar ankesa e të autorizuarit të paditurës dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.986/16 datë 27.6.2017, në pikën I dhe II të dispozitivit përkitazi me dëmin jo material për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shëmtimit dhe rehabilitimit fizioterapeutik ashtu që është detyruar e paditura që paditësit t'ia paguaj në emër të kompensimit për dhimbjet fizike shumën prej 4.000 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 3.000 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 10.000 €, në emër të shëmtimit shumën prej 3.500 € si dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik shumën prej 190 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar për këto kategori të dëmit, është refuzuar si e pabazuar. Me pjesën II të dispozitivit është pranuar pjesërisht ankesa e të autorizuarit të paditësit dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren,

C.nr.986/16 datë 27.6.2017, në pikën II të dispozitivit përkitazi me kamatën e gjykuar ashtu që është detyruar e paditura që paditësit për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë t'ia paguaj kamatën ligjore në shkallë prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë më 27.6.2017, e deri në pagesën definitive. Me pjesën III të dispozitivit janë refuzuar si të pabazuara ankesat e paditësit dhe të paditurës, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pikën II të dispozitivit sa i përket dëmit material për shpenzimet e shërimit dhe në pikën III dhe IV të dispozitivit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar duke caktuar shumat për kompensim sipas precizimit të autorizuarit të paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e kundërshtuar konform nenit 215 të LPK-së dhe gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 1.8.2016, në autostradën Prizren - Vërmicë, H. R., duke drejtuar automjetin e markës "Mercedes" me targë të regjistrimit ..., me policë sigurimi të shtetit të huaj, ka shkaktuar fatkeqësinë e komunikacionit, ashtu që e godet policin – këtu paditësin i cili në atë moment ishte në detyrë zyrtare – policë i komunikacionit, i cili me kohë kishte dhënë shenjën përkatëse me bateri për tu ndalur, mirëpo shoferi i automjetit nuk e kishte vërejtur me kohë dhe e kishte goditur, me ç'rast paditësi si pasojë e goditjes ka pësuar frakturë bifokale të hapur të shkallës së II të kërcirit të djathtë, frakturë shumë fragmenteshë të kërcirit të majtë, frakturë e kllavikullës së djathtë, të cilat lëndime karakterizohen si lëndime të rënda trupore, që si pasojë paditësit i kanë shkaktuar dhimbje trupore, frik, zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 25%, shëmtim, ka pas nevojë për rehabilitim fizioterapeutik, si dhe i janë krijuar shpenzime për shërim.

E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesëpadisë duke i ofruar këtu paditësit për të gjitha llojet e dëmit shumën prej 16.000 €, duke e zbritur shumën prej 2.000 €, të cilën paditësi e ka marrë si akontacion në procedurën administrative.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material e material, është shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës pjesërisht ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale në pjesën që ka të bëjë me shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet procedurale, ndërsa ka vlerësuar se lidhur me kompensimin e dëmit për dhimbje fizike, frikë zvogëlimin e aktivitetit jetësor, shëmtim, rehabilitim fiziko terapeutik dhe kamatën, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale dhe në këtë pjesë ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit pjesërisht është e bazuar. Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit, të cilat arsye i mbështetë edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Pretendimin e revizionit se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është i pabazuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë, nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe përmban arsye të mjaftueshme për gjykim të drejtë e të ligjshëm. Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Paditësi në revizion nuk ka cekur asnjë dispozitë ligjore apo pretendim konkret se ku qëndrojnë shkeljet e pretenduara.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt

kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate mbi gjendjen e tillë faktike gjykata e shkallës së dytë drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 200 të LMD -ës lidhur me nenin 323 të LPK -ës, përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit jo material për dhimbjet fizike në shumën prej 4.000 €, për frikën e përjetuar shumën prej 3.000 €, zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 25% shumën prej 10.000 €, për shëmtim trupor shumën prej 3.500 € dhe për rehabilitim fizikoterapeutik shumën prej 190 €, ngase, këto shuma të gjykuara janë caktuar në bazë të ekspertizës mjekësore nga ekspertët Dr. V. B. – ortoped traumatolog dhe Dr. V. B.- psikiatër. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD duhet të kujdeset për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me të favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimit shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditësit, shkallën e intensitetit të dhimbjeve trupore, frikës së përjetuar, zvogëlimit të aktivitetit jetësor në shkallën prej 25%, shëmtimit trupor, rehabilitimit fiziko terapeutik dhe praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shuma e caktuar e shpërblimit të dëmit paditësit nga ana e gjykatës së shkallës së dytë sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është reale dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas kësaj dispozite, për të cilën arsye gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar të drejtën materiale, kur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ndryshuar ashtu që ka gjykuar shumat e cekura si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Pretendimin e paditësit të cekur në revizion se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale kur ka aprovuar ankesën e të paditurës dhe ka zvogëluar shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit jetësor, shëmtimin trupor dhe për shërim fiziko terapeutik, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase, gjykata e shkallës së dytë me të drejtë ka vlerësuar se përcaktimi i kompensimit në shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë nuk përkon me rëndësinë e të mirës së cenuar dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim dhe praktikën gjyqësore, sepse shumat e gjykuara do të ja mundësojnë paditësit plotësimin e nevojave të përditshme duke ja bërë kështu ma të lehtë jetën e tij dhe harruar përjetimet e pakëndueshme të cilën e ka përjetuar si pasojë e lëndimeve të marra nga aksidenti, duke u

siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësin dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale. Andaj nga arsyet e cekura , Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se janë të pabazuara pretendimet e paditësit se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të gabuar ka zbatuar nenin 190 dhe nenin 200 par. 2 të LMD –ës.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimin e paditësit të cekur në revizion se ai është kryefamiljar dhe me reduktimin e tillë të aftësisë jetësore dhe punuese, i njëjti nuk do të mund të punojë siç ka qenë para aksidentit dhe të mbaj veten e familjen e tij dhe duke marrë edhe për bazë shpenzimet mjekësore të cilat do ti ketë në vazhdimësi, shumat e zvogëluara nga gjykata e shkallës së dytë janë jo reale dhe nuk përkojnë me lëndimet trupore të cilat i ka pësuar paditësi në fatkeqësinë e komunikacionit, e sidomos duke marr për bazë se edhe gjykata e shkallës së parë ka caktuar shuma të ulëta për kompensim, por një pretendim i tillë nuk ndikoi që kjo Gjykatë të vendosë ndryshe, ngase, gjykata e shkallës së dytë kur ka gjykuar shumat si në dispozitivin e aktgjykimit të saj ka marrë për bazë të gjitha kriteret e përcaktuara ligjore duke u kujdesur që kompensimi të jetë satisfaksion për paditësin dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr. 191/2019 datë 12.6.2019

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku